



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.09.2020 të parashtruar nga Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N. "Vizion Plus", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc", me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si** e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N. "Vizion Plus", e dt. 02.09.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc", me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, të AK -së, të datës 28.08.2020 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë: 28.08.2020;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Grupit të operatorëve ekonomik "Joos & Krasniqi-Bazë" sh.p.k. & N.P.N. "Vizion Plus", me datë 02.09.2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shtegut për ecje dhe ciklizëm Çabrat-Jahoc", me Nr. të Prok: 632-20-1308-5-2-1.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.07.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues, konstaton se Grupit të operatorëve ekonomik "Marisa" sh.p.k. & "Company Murseli" sh.p.k., është me çmimin më të ulët, prandaj Autoriteti Kontraktues, mbetet pranë vendimit të marrë.

Sa ju përket juve, tenderi juaj nuk është i suksesshëm për arsye se çmimi i juaj nuk është më i ulëti në mesin e tenderëve që plotëson kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

Faton Gutaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

